



Vlerësimi i zbatimit të Ligjit për
Mbrojtjen e Fëmijës në shkollat fillore
dhe institucionet e komunës së Prizrenit

Dhjetor, 2024

Përmbajta

1. Hyrje.....
- 1.1 Qëllimi i hulumtimit.....
- 1.2 Metodologjia.....
2. Struktura e të anketuarve dhe njohuritë e nxënësve në lidhje me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve.....
3. Angazhimi institucional në ndërmarrjen e masave për mbajtjen e fëmijëve.....
4. Mbikëqyrja institucionale.....
5. Rekomandimet.....

1. Hyrje

1.1 Qëllimi i punimit

Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve hyri në fuqi në vitin 2020, duke ofruar një arritje historike në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve duke vendosur një kuadër ligjor gjithëpërfshirës për garantimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e abuzimit, shfrytëzimit, neglizhencës, dhunës fizike dhe mendore, apo të tjera. që mund të rrezikojnë jetën, sigurinë, shëndetin, arsimimin ose zhvillimin e fëmijëve¹.

"Kemi konstatuar që ligji nuk është duke u zbatuar. Kemi paraqitur rekomandim për autoritetet ekzekutive dhe të tjera që kanë detyrime ligjore për t'i nxjerr aktet nënligjore si mekanizma të cilat kanë për ta funksionalizuar ligjit". Për më tepër nuk ka ndëshkueshmëri për mos zbatim të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, dhe mbi bazën e ankesave, janë identifikuar fushat ku më së shumti preken të drejtat e fëmijëve².

Qëllimi kryesor i këtij hulumtimi është të bëjë një përpjekje për të adresuar problemin e Zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga ana e institucioneve qendrore me theks nga ana e institucioneve lokale të komunës së Prizrenit, në perceptimin e vet fëmijëve lidhur me njohjen dhe zbatimin e këtij ligji në praktikë nga ana e institucioneve posaçërisht nga ana e institucioneve arsimore të komunës së Prizrenit dhe dhënien e rekomandimeve konkrete për institucionet e qendrore dhe lokale në përmirësimin e zbatimit të ligjit në fjalë.

1.2 Metodologjia

Metodologjia e hartimit të këtij hulumtimi është bazuar kryesisht në hulumtimet empirike kuantitative (si të dhëna dytësore) nga hulumtimet paraprake për zbatimin në përgjithësi në nivel vendi të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës. Sa i përket të dhënave kualitative (si të dhëna parësore) për vlerësimin e zbatimit të Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës në shkollat fillore dhe institucionet e komunës së Prizrenit për Edukimin dhe Arsimimin, Raportimi i Rrezikut, Qasja e Drejtë në Drejtësi, Qasja e Fëmijëve me aftësi të kufizuar është përdorë metoda e anketimit me nxënësit e SHFMU dhe SHFML të komunës së Prizrenit.


¹ <https://childhub.org/sg/online-biblioteka-o-djecijoi-zastiti/gjendja-e-te-drejtave-te-femijeve-kosove>

² Naim Qelaj – Avokatit i Popullit, Tryezw diskutimi me pwrfaqwsues institucionesh i datws 03.02.2023, <https://www.aa.com.tr/sg/balkani/avokati-i-popullit-n%C3%AB-kosov%C3%AB-ligji-p%C3%ABr-mbrojtjen-e-f%C3%ABmij%C3%ABs-nuk-zbatohet/2811703>


Pyetësori është përpiluar në “google forms” dhe është realizuar nga anëtarët e Asamblesë së Fëmijëve nga data 7 deri më 13 dhjetor 2024. Të dhënat nga anketimi janë gjeneruar në sistem në mënyrë automatike në sistem dhe janë komentuar nga përfaqësuesit e Asamblesë Komunale të Fëmijëve. Me qëllim të fasilimitit të ekipit të AKF, Nevo Koncepti ka angazhuar një ekspert të jashtëm, ku ka ndihmuar AKF në përpilimin e pyetjeve, në ndërtimit e pyetjeve në platformën e google forms, në dhënien e udhëzimeve të tjera në komentimin e rezultateve nga realizimi i anketës me nxënësit e SHFMU dhe SHFML të komunës së Prizrenit.

2. Struktura e të anketuarve dhe njohuritë e nxënësve në lidhje me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve


Në kuadër të realizimit të hulumtimit mbi njohuritë e nxënësve në lidhje me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, kanë marrë pjesë gjithsej 102 të anketuar, ku dominon grup moshë nga 13-15 vjet me gjithsej 62 të anketuar, përcjellur nga grup moshë nga 16-18 vjet me 24 të anketuar dhe grup moshë nga 10-12 vjet me 16 të anketuar. Sa i përket strukturës gjinore të të anketuarve, nga 102 të anketuarve, 71 prej tyre apo 69.60% kanë qenë vajza dhe 31 prej tyre apo 30.40 djem.



Sa i përket strukturës etnike, nga 102 të të anketuarit si pjesë e këtij hulumtimi, 95 prej tyre apo 93% kanë qenë shqiptar, 1 boshnjak, 1 turk, rom dhe 2 tjerë.




Në pyetjen se a kanë informata se ekziston Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve, nga 102 të anketuar, 88 prej tyre apo 86.27 % kanë deklaruar se kanë informacione që ekziston ligji I tillë derisa 14 prej tyre apo 13.73 % kanë deklaruar se nuk kanë informata se ekziston një ligj I tillë në Kosovë.




3. Angazhimi institucional në ndërmarrjen e masave për mbrojtjen e fëmijëve

Nga 102 të anketuar 36 prej tyre apo 35.30% mendojnë që komuna nuk është e angazhuar mjaftueshëm në ndërmarrjen e masave mbrojtëse dhe ri-integruese për mbrojtjen e fëmijëve brenda territorit të saj, derisa 25 prej tyre apo 24.5% mendojnë të kundërtën. Një numër relativisht i lartë i të anketuarave

përkatësisht 41 prej tyre apo 40.2% nuk kanë informata nëse komuna është duke u angazhuar mjaftueshëm në këtë drejtim.




Nga 102 të të anketuarve, 40 prej tyre apo 39.20% kanë informata mbi atë se Komuna e Prizrenit e ka themeluar Ekipin për të Drejtat e Fëmijëve ndërsa 19 prej tyre apo 18.60% nuk kanë informata të tilla. Një numër tejet i lartë i të anketuarve përkatësisht 43 prej tyre apo 42.20 % janë përgjigjur se nuk e din nëse Komuna e ka themeluar Ekipin për të Drejtat e Fëmijëve.




Nga 102 të të anketuarve, 45 prej tyre apo 44.10% mendojnë se komuna është duke bërë mjaftueshëm për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në aspektin mësimor, 37 prej tyre apo 36.30% mendojnë të kundërtën dhe 30 prej tyre apo 19.60% nuk e din nëse komuna është duke bërë mjaftueshëm në aspektin e mbrojtjes së fëmijëve me aftësi të kufizuar në çështjet e arsimit të tyre.

Sipas jush, a mendoni që komuna është duke bërë mjaftueshëm për mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në aspektin arsimor?



Nga 102 të të anketuarve, 34 prej tyre apo 33.30 % kanë deklaruar se shkolla ku ata vijnë mësimin zbaton programe edukativo arsimore që kanë për qëllim sensibilizimin për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve. Megjithatë një numër i konsiderueshëm përkatësisht 36 prej tyre apo 35.30 % kanë deklaruar të kundërtën dhe 32 prej tyre apo 31.40% nuk kanë informata nëse shkolla zbaton programe edukativo arsimore që kanë për qëllim sensibilizimin për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve.


A zbaton shkolla ku ju vijoni mesimin programe edukativo-arsimore që kanë për qëllim sensibilizimin për mbrojtjen dhe kujdesin ndaj fëmijëve?



Nëse përgjigja është Po, cilat janë ato programe edukativo arsimore që i ka ndër marrë shkolla, nga 34 të të anketuarve, kanë spikatur aktivitetet e tilla si: ligjëratat për autizmin, aktivitete kundër bullizmit, aktivitete të ndryshme, sesione informuese nga psikologët në shkolla, aktivitetet e ndryshme shkollore më

këshillin, programe të ndryshme që ngrisin ndërgjegjësimin etj. Përkundër deklaramit se shkolla zbaton programe të tilla edukativo arsimore me qëllim senzibilizimi edhe në këtë pjesë, 6 nga të të anketuarve kanë deklaruar se nuk ka asnjë aktivitet të karakterit të tillë senzibilizues.


Nga 102 të të anketuarve, 50 prej tyre apo 48% janë deklaruar se personeli arsimor dhe personeli i lidhur me shkollën përdor ndëshkimin trupor ndaj fëmijëve si mjet i disiplinës. 25 prej tyre apo 25.50% janë deklaruar se personeli arsimor dhe personeli i lidhur me shkollën përdorë ndëshkimin trupor dhe 27 prej tre apo 26.50% janë deklaruar se nuk kanë informata apo nuk e din nëse personeli arsimor dhe personeli i lidhur me shkollën përdorë ndëshkimin trupor ndaj fëmijëve si mjet i disiplinës.



4. Mbikëqyrja institucionale


Në pyetjen se a mendoni që Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është duke bërë mjaftueshëm që përmes inspektoratit të monitoron zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve brenda institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese, nga 102 të të anketuarve 40 prej tyre apo 39.20% janë deklaruar se nuk e din, 36 prej tyre apo 35.30 % janë deklaruar se Ministria është duke bërë mjaftueshëm dhe 26 prej tyre apo 25.50% janë deklaruar se Ministria nuk është duke bërë mjaftueshëm që përmes inspektoratit të mbikëqyrë zbatimin e politikave për mbrojtjen e fëmijëve brenda institucioneve edukative arsimore dhe aftësuese

A mendoni që Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) është duke bërë mjaftushëm që përmes inspektoratit të monitoron zbatimin e politikave të mbrojtjes së fëmijëve brenda institucioneve...




Nga 102 të të anketuarve, 35 prej tyre apo 34.30 % mendojnë që Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren po mbikëqyr dhe siguron që të gjitha institucionet edukativo-arsimore, i kanë hartuar dhe zbatojnë politikat për mbrojtjen fëmijës, 39 prej tyre apo 38.20% nuk kanë din dhe 28 prej tyre apo 27.50% janë shprehur se DKA nuk po mbikëqyr dhe siguron që të gjitha institucionet edukativo-arsimore, i kanë hartuar dhe zbatojnë politikat për mbrojtjen fëmijës.

A mendoni që Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren po mbikëqyr dhe siguron që të gjitha institucionet edukativo-arsimore, i kanë hartuar dhe zbatojnë politikat për mbrojtjen fëmijës?



Nga 102 të të anketuarve, 36 prej tyre apo 35.30 % mendojnë që shkolla ka siguruar edukimin për mbrojtjen e fëmijëve, 34 prej tyre apo 33.30 % mendojnë të kundërtën dhe 32 prej tyre apo 31.40% nuk e dinë nëse shkolla ka siguruar edukimin për mbrojtjen e fëmijëve?


A mendoni që shkolla ka siguruar edukimin për mbrojtjen e fëmijëve?



Në pyetjen, nëse po, nga cilat veprime ka siguruar edukim për mbrojtjen e fëmijëve, nga 36 të të anketuarve që janë përgjigjur pozitivisht në atë se shkolla ka siguruar edukimin për mbrojtjen e fëmijëve, 17 prej tyre kanë dhënë edhe përgjigjet mbi atë se cilat nga veprimet i ka ndërmarrë shkolla në këtë drejtim. Veshja e uniformave, sesionet informuese, vendosja e policisë në rrugë afër shkollave, edukim për sigurinë personale dhe mësim për dhunë dhe keqtrajtim, bullizmi është i shpeshtë akoma por edukohemi në mënyrë të barabartë të gjithë nxënësit, në shkollë ka sigurim dhe jemi në mbikëqyrjeje të arsimtarëve dhe drejtorit vazhdimisht etj.

Në pyetjen se a keni informacione, a është themeluar Shtëpia për mbrojtjen e fëmijëve në komunën e Prizrenit, nga 102 të të anketuarve vetëm 17 prej tyre apo 16.60 % kanë deklaruar se kanë informacione, 28 apo 27.50% kanë deklaruar se nuk kanë informacione dhe 57 prej tyre apo 55.90% e të të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë informacione nëse është themeluar Shtëpia për mbrojtjen e fëmijëve në komunën e Prizrenit.

A keni informacione, a është themeluar Shtëpia për mbrojtjen e fëmijëve në komunën e Prizrenit?



5. Rekomandimet:

- Ndërmarrja e veprimeve konkrete në sensibilizimin më të madh të nxënësve lidhur me të drejtat që garantohen me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Sensibilizimin më të madh të nxënësve lidhur me të ndërmarrjen e veprimeve konkrete të institucioneve në zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- Komuna të ndërmerr hapa konkret në ndërmarrjen e masave mbrojtëse dhe ri-integruese për mbrojtjen e fëmijëve brenda territorit të me theks në mbrojtjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në aspektin mësimor;
- Ndërmarrja e masave konkrete në informimin e nxënësve për raportimin tek institucionet gjegjëse në rastet eventuale të ndëshkimit trupor të nxënësve nga personeli arsimor dhe personeli i lidhur me shkollën;
- Angazhimi më i madh i Inspektoratit në monitorimin e zbatimit të politikave të mbrojtjes së fëmijëve brenda institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese;
- Angazhimi më i madh nga Drejtoria Komunale e Arsimit në Prizren në mbikëqyrjen dhe sigurimin të gjitha institucionet edukativo-arsimore, i kanë hartuar dhe zbatojnë politikat për mbrojtjen fëmijës.